# BANESAT

Atje ku ka qënë e mundur, mund të thomi se katundet përgjithësisht janë ngrehur afër ujit. Shtëpitë, nga frika e vrasjes me shoqi shoqin, janë goditur larg prej njëra-tjatrës, dhe njeriu mund të ecë për një kohë të gjatë gjer sa të arijë në shtëpin e fundit të fshatit.

Kam parë shtëpi në majë të shkëmbit, në vënde të izolluar, dhe mëndja e njeriut habitet si mund të rojnë n' atë vënt ku komunikasioni ka qënë kaq i vështirë. Mprojtja dhe toka për të mbjellë caktojnë pozitën e shtëpive të tyre. Sosiabiliteti s' është marë para sysh sepse çdo shtëpi ka qënë e pavarur nga njëra-tjatra.

E rethuar prej ndonjë toke të mbjellë, qëndron shtëpia e Mirditasit; për t' i bërë ballë luftravet, është goditur e fortë prej gurri. Dritaret i ka të vogla, për mi portë përgjithësisht është "çykmaja" me një pënxhere të vogëlë dhe me disa "frëngji" për të bërë luftë. Në për qoshet e shtëpisë do shëkojë njeriu vrima të tjera të cilat mprojnë shtëpinë nga të gjithë anët. Shtëpitë me dy kate i thonë kullë. Mbulojën e ka me pllaca, me qeramidhe ose, atje ku ka pyje me pishë, me drasë. Që për së largu dukeа si kutiçka pe shpirtoje.